

## HAMIT KABA

### REFUZIMI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR TË NJOHUR QEVERTË E DALA NGA KONGRESI I PËRMETIT DHE Mbledhja E BERATIT, MAJ - NËNTOR 1944

Periudha maj-nëntor 1944 përbën një fazë të veçantë në marrëdhëniet e Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar (FANÇ) me Aleatët e Mëdhenj. Gjatë kësaj periudhe detyrat ushtarake për çlirimin e vendit pleksen me objektivat politike. *Së pari*, formimi i Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar me atributet e një Qeverie të Përkohshme në Kongresin e Përmetit dhe i Qeverisë së Përkohshme Demokratike në Mbledhjen e Beratit, ndeshën në refuzimin e tre Aleatëve të Mëdhenj; *së dyti*, dy Aleatët e Mëdhenj perëndimorë në takimin e Barit [korrik-gusht 1944] e njohën Lëvizjen Nacionalalçlirimtare (LNÇ) si të vetmen forcë të rezistencës në Shqipëri. Pas këtij vendimi, me iniciativën e Sekretarit Britanik të Shtetit Anthony Eden, më 5 tetor 1944 ata e tërhoqën plotësisht mbështetjen e tyre për Ballin Kombëtar dhe Legalitetin; *së fundi*, të tre Aleatët e Mëdhenj morën vendimet përkatëse për të dërguar në Shqipëri misionet e tyre, të cilët do të studionin gjendjen në vend dhe do të procedonin më tej për njohjen e regjimit të ri.

#### Kongresi i Përmetit

Kongresi i Përmetit dhe Mbledhja e Beratit shënojnë në fakt fillimin e marrjes së pushtetit politik nga Partia Komuniste Shqiptare (PKSH), e veshur me petkun e Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar. Kjo ide është përmendur në disa studime, të ‘vjetra’ apo të reja. “Është e qartë, - shkruan Luan Omari, se pushteti ynë popullor që porsa doli nga Lufta Nacionalalçlirimtare, nuk ishte thjeshtë një diktaturë demokratike e forcave revolucionare, siç e kuptonte këtë V.I. Lenini, por një formë e diktaturës së proletariatit”.<sup>1</sup> Këtë ide e ka mbështetur edhe Sejfulla Malëshova, në disa shkrime e intervista të tij, gjatë vitit 1944 dhe 1945.<sup>2</sup> Kuvendi i Përmetit, ka

<sup>1</sup> Luan Omari, *Revolucioni popullor në shqipëri dhe çështja e pushtetit*, Universiteti i Tiranës, Tiranë: Mihal Duri, 1977, f. 121.

<sup>2</sup> *The National Archives and Record Administration* (më tej: NARA), RG 226, Entry 16, Box. 1098, File 95542, p. 3. “Sejfulla Malëshova flet për programin e Frontit”, në

theksuar Romeo Gurakuqi, ka qenë një pikë kthese në luftë dhe në projektimin e pushtetit të pasluftës.<sup>3</sup> “Forcat e Komitetit Nacional [Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar H.K], ka shkruar Konstandin Çekrezi, ish in organe të një revolucioni përmbysës të gjithë sistemit të vjetër politik, shoqëror, ekonomik, për të vënë në vend të tij një sistem krejt të ri”.<sup>4</sup> “Neni 2 i kushtetutës të miratuar në mars 1946, ka shkruar Tajar Zavalani, përmendte se, pushteti popullor në Shqipëri ushtrohet nga organet politike që u krijuan gjatë luftës për çlirim kombëtar nga sundimi fashist dhe forcat reaksionare të mbrendëshme”.<sup>5</sup> “Kongresi, ka shkruar Bernd J. Fischer, miratoi gjithashtu një sërë vendimesh afatgjata, të cilat pjesërisht përbënin bazën e ndërtimit të ardhshëm të shtetit shqiptar”.<sup>6</sup>

Pushteti i fituar gjatë Luftës do të legjitimohej e përsosej më tej, pas mbarimit të saj, përmes zgjedhjeve të përgjithshme, por esenca e tij nuk do të ndryshonte. Aleatët e Mëdhenj e pranuan dhe e njohën rolin e veçantë të LNÇ, si e vetmja forcë e rezistencës në vend, në takimin e dy delegacioneve që përfaqësonin Shtabin Aleat të Mesdheut dhe Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare në Bari të Italisë . Ky status u konkretizua me atashimin e misioneve ushtarake përkatëse në Itali e në Shqipëri. Ndonëse me terma diplomatikë refuzimi i qeverive anglo-amerikane kishte sfond të qartë politik. Vendimet dhe programet politike, mënyra e zgjedhjes së delegatëve dhe koha e mbajtjes së Kongresit të Përmetit, ushqyen dyshime të forta tek Aleatët Perëndimorë, të cilët morën sinjale të mjaftueshme për perspektivën e vendosjes së një regjimi totalitar komunist në Shqipëri.

Qeveritë e FNÇ, të dala nga Kongresi i Përmetit dhe Mbledhja e Beratit, nuk u njohën as nga qeveria e Bashkimit Sovjetik. Duket se qeveria sovjetike e gjykoi si më oportune të mos ndahej nga dy vendet e tjera aleate, ndonëse nuk kishte rezerva të natyrës politike. Ndarja e hapur ndërmjet qeverisë sovjetike dhe dy qeverive perëndimore në lidhje me qëndrimin ndaj Shqipërisë do të ndodhte vetëm pas zgjedhjeve të 2 dhjetorit të vitit 1945.

---

*Bashkimi*, Tiranë: 20 nëntor 1945; shih: *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar*, vëll. IV (maj1944-nëntor 1944), Tiranë: 8 Nëntori, 1989, f. 63.

<sup>3</sup> Romeo Gurakuqi, *Shqipëria dhe Tokat e Lirume (1939-1946)*, Tiranë: Botimet Jozef, 2018, f. 744.

<sup>4</sup> Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 58.

<sup>5</sup> Tajar Zavalani, *Histori e Shqipnis*, Tiranë: Plejad , 2019, f. 464.

<sup>6</sup> Bernd J. Fischer, *Shqipëria gjatë Luftës (1939-1945)*, përktheu Krenar Hajdëri, Tiranë: Çabej, 1999, f. 321.

Kongresi i Përmetit shënoi të parën kërkesë për njohje nga brenda vendit. Kërkesat e qeverive të FNÇ, në dallim nga kërkesat e bëra nga Zogu dhe emigracioni shqiptar, duhet përmendur se ishin më imponuese, sepse vinin nga një forcë ushtarake e politike me peshë të madhe në rezistencën e shqiptarëve, dhe me mbështetje brenda vendit.

Mënyra se si u organizua Kongresi i Përmetit dhe vendimet që ai mori, ngjajnë shumë me vendimet që u miratuan në Konferencën apo Kongresin e Dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë [AVNOJ] në Jajce, në nëntor 1943. Dokumentet e Kongresit të Përmetit u sollën nga BLO-të [British Liaison Officer-oficer ndërlidhës britanik] në Bari dhe aty u përkthyen në gjuhën angleze.<sup>7</sup>

Kongresi i Përmetit mori një varg vendimesh me natyrë politike, ushtarake, legjislativë e ekzekutive. Disa nga vendimet me natyrë politike të këtij Kongresi u pritën me shqetësim në Washington e në Londër. Në veçanti tërhoqi vëmendjen e tyre vendimi që kishte të bënte me krijimin e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar me funksionet e një Qeverie të Përkohshme. Vendimet e tij nuk kishin të bënin vetëm me periudhën e Luftës, por me të ardhmen e Shqipërisë dhe rrugën e zhvillimit të saj në periudhën e pasluftës.

Shtabi i Përgjithshëm i UNÇ, më 21 maj 1944 kishte ftuar toger Thomas Stefan-in [Tom Stefani] me cilësinë e oficerit të ndërlidhjes amerikane dhe kolonelin britanik Philip Leak, përfaqësues i misioneve britanike në Shqipëri, që të merrnin pjesë si dëgjues në Kongresin e Përmetit.<sup>8</sup> Ndërsa Office of Strategic Services [OSS-Zyra e Shërbimeve Strategjike] e pranoi ftesën dhe dërgoi përfaqësuesin e saj Thomas Stefan-in<sup>9</sup>, koloneli Leak refuzoi të merrte

<sup>7</sup> R. Gurakuqi, *Shqipëria dhe Tokat e Lirume ...*, f. 744.

<sup>8</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 41, viti (më tej: V.) 1944, dosja (më tej: D.) 146, fl. 1-2.

<sup>9</sup> Thomas apo Tom Stefani mori pjesë në Kongresin e Përmetit si përfaqësues i misioneve ushtarake amerikane në Shqipëri. Si person me origjinë shqiptare ai e njihje mirë gjuhën dhe zakonet e vendit. Toger Stefani mori pjesë edhe në Kongresin e Rinisë Antifashiste të mbajtur në Panarit më 8-11 gusht 1944, ku britanikët sërish nuk dërguan përfaqësues. Përveç informacioneve për Kongresin e Përmetit ai i përcolli qendrës së vet edhe disa fotografi të pjesëmarrësve, të cilat iu përcollën Departamentit të Shtetit dhe më vonë u arkivuan. Gjatë kërkimeve tona në *The National Archives and Record Administration [NARA]* në Maryland -USA, në mars 2004, ndërmjet të tjerave pamë disa nga fotografitë e bëra prej tij në maj 1944. Mua dhe koleges prof. dr. Ana Lalaj na bënë përshtypje të veçantë ato foto, të cilat përmbanin emrat e disa personave pjesëmarrës apo të zgjedhur në Kongres, fotot dhe emrat e të cilëve ishin hequr pas dënimit apo përjashtimit të tyre nga PKSH-PPSH. Na lanë mbresa sidomos fotot e Sejfulla Maleshovës, Koçi Xoxes, Bedri Spahiut, Mehmet Shehut etj. Shih:

pjesë në kongres, duke u shprehur se ‘ftesa juaj nuk pajtohet me vendimin tuaj të fundit, për të mos më lejuar mua që të vizitoj misionin aleat në krahinën e Mallakastrës’.<sup>10</sup> I njëjti refuzim erdhi edhe nga oficeri tjetër britanik Alan Palmer. Duket se britanikët e parandien atë çka do të vendosej në Kongresin e Përmetit, ndonëse e justifikuan pakënaqësinë e tyre me një shkak të zakonshëm, se ata ishin penguar që të shkonin në zonën e Mallakastrës. Arsyeya e vërtetë, siç shpjegon Kristo Frashëri, kishte të bënte me faktin se Enver Hoxha e refuzoi në mënyrë kategorike kërkesën e Leak e Palmer, që në punimet e Kongresit të merrnin pjesë edhe përfaqësuesit e Ballit Kombëtar dhe të Legalitetit.<sup>11</sup> Dy përfaqësuesit e misioneve britanike në Shqipëri shpresonin që t’i afronin me LNÇ në luftë kundër pushtuesit gjerman.

Vendimet që kishin të bënin me emërimin e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar me funksionet e një qeverie të përkohshme; mosnjohja e asnjë qeverie që do të formohej në kundërshtim me vullnetin e lirë të popullit shqiptar brenda ose jashtë vendit; ndalimi i kthimit të Mbretit Zog në Shqipëri për shkak se çështja e regjimit do të vendosej nga populli pas çlirimit të vendit; rishqyrtimi i të gjitha marrëveshjeve të firmosura me fuqitë e huaja, dhe anulimi i të gjitha pakteve ekonomike e politike të firmosura nga qeveria e Zogut; mosnjohja e të gjitha marrëveshjeve dhe aleancave ndërkombëtare që mund të nënshkruheshin brenda ose jashtë Shqipërisë nga ‘qarqet reaksionare’; përfshirja në listën e armiqve të LNÇ të gjitha organizatave të tjera, duke përfshirë edhe organizatën e Legalitetit, apo të përdorimit të shprehjeve me natyrë ideologjike, se në listën e armiqve do të përfshihej edhe ‘ndonjë klikë tjetër reaksionare në të ardhmen’ kishin të bënin me të tashmen, por edhe me të ardhmen e Shqipërisë.<sup>12</sup>

Raporti i gjatë prej 16 faqesh i mbajtur nga Enver Hoxha në Kongres, u konsiderua si emotiv dhe me përmbajtje të fortë ideologjike.<sup>13</sup> Vendimet dhe kërkesat e natyrës ushtarake të Kongresit synonin në thelb të siguronin

NARA, RG 226, Fultz për Adams, 11 tetor 1944. Për Tom Stefanin shih librin e Peter Lucas në shqip: *Misioni Amerikan në Shqipëri*, përktheu Xhevdet Shehu, Tiranë: Bota Shqiptare, 2008.

<sup>10</sup> *AQSH*, F. 41/APL, V. 1944, D. 146, fl. 2; *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AMPJ*), V. 1944, D. 12.

<sup>11</sup> Kristo Frashëri, *Kongresi i Përmetit (24-28 maj 1944). Vështrim historik dhe burime dokumentare*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: 2015, f. 79-80.

<sup>12</sup> NARA, RG 226, File 82715, f. 12. Dokumente të Kongresit të Përmetit, 6 korrik 1944.

<sup>13</sup> *Po aty*, RG 226, Box 1074, File 93480, f. 1-16. “Fjalimi i Enver Hoxhës në Kongresin e Përmetit”, 4 shtator 1944.

njohjen e LNÇ nga Aleatët, si të vetmen forcë që luftonte me gjermanët, shtimin e adresimin e ndihmave vetëm për partizanët shqiptarë, dhe refuzimin e dhënies së tyre për forcat kundërshtarë nacionaliste. Kongresi kërkoi më shumë furnizime ushtarake për LNÇ në të ardhmen, akreditimin e përfaqësuesve të Komandës së Lartë Aleate pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe anasjelltas etj. Në Kongres u shpreh dëshira për praninë më të gjerë të misioneve të Bashkimit Sovjetik dhe SHBA në Shqipëri, dhe përfaqësimin e plotë të tyre pranë Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ. Në raportin e gjatë që mbajti Enver Hoxha nuk harroi tu kujtonte Aleatëve, se ata duhej të premtonin që nuk do të punonin më me elementët tradhtarë të Shqipërisë<sup>14</sup>, duke nënkuptuar, siç treguan ngjarjet e mëvonshme ekipin britanik të kryesuar nga Bill Maclain të atashuar pranë Abaz Kupit.

Nga Kongresi i Përmetit iu dërguan telegrame Presidentit Roosevelt, kryeministrit Churchill dhe Mareshalit Stalin dhe shqiptarëve të Amerikës.<sup>15</sup> Përshëndetja që iu përcoll Mareshalit Stalin në emër të popullit sovjetik ishte më e ngrohtë dhe më miqësore. Nga Kongresi i Përmetit iu dërgua edhe një përshëndetje shqiptarëve të Amerikës. “Kongresi pret nga vëllezërit e Amerikës që këta t’i japin popullit shqiptar ndihmën e tyre morale dhe materiale sot në luftën që po bën kundër okupatorëve e tradhtarëve dhe nesër për rindërtimin e Shqipërisë”<sup>16</sup>.

Zgjedhja e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar me atributet e një qeverie të përkohshme në Kongresin e Përmetit dhe vendimi i tij për ndalimin e kthimit të Zogut në Shqipëri, krijoi një situatë të re në Departamentin e Shtetit [DSH] për Shqipërinë. Qeveria amerikane duhej të shprehej për njohjen apo mosnjohjen e qeverisë së dalë në Përmet, por edhe për vendimet e tjera të tij. Në Kongres nuk ishin përfaqësuar të gjithë shqiptarët, por vetëm ajo pjesë e popullsisë së lidhur me FNÇ. Qeveria e Përmetit vinte nga rrethanat e luftës dhe jo nga zgjedhjet e përgjithshme. Vendimi për ndalimin e kthimit të Zogut në Shqipëri e minimizonte, në mos e përjashtonte atë nga gara e ardhshme për pushtet. Ky hap i ndërmarrë në Kongresin e Përmetit binte ndesh me Kartën e Atlantikut, e cila nuk i krijonte monopolin e pushtetit asnjë force politike për të ardhmen, por as i përjashtonte ata nga gara. Deri në kohën e ndarjes së Legalitetit nga FNÇ dhe daljes së tij si organizatë e pavarur, vështirë të gjeje ndonjë prononcim zyrtar

<sup>14</sup> *Po aty*, RG 226, File 82715, f. 11. Dokumente të Kongresit të Përmetit, 6 korrik 1944.

<sup>15</sup> *AQSH*, F. 40, V. 1944, D. 20, fl. 1-8.

<sup>16</sup> *Po aty*, fl. 8.

për Zogun dhe ardhjen e tij në pushtet. Heshtja ishte marrë deri-diku si pranim. Në fakt, udhëheqja komuniste e kishte shmangur prononcimin e parakohshëm për këtë çështje. Analiza e kërkesave dhe vendimeve të marra në Kongresin e Përmetit të çon në konkluzionin, se aty po skicohej e ardhmja jo tradicionale e Shqipërisë, përjashtimi nga pushteti i çdo force tjetër përveç FNÇ dhe njohja ushtarake e LNÇ, si e vetmja forcë e rezistencës në Shqipëri.

### **Reagimi i qeverisë amerikane ndaj Kongresit të Përmetit**

Informacionin e parë për natyrën e Kongresit e transmetojë më 28 qershor përfaqësuesi amerikan pranë Shtabit të Forcave Aleate në Agjer, Chapin.<sup>17</sup> Ai e informonte Sekretarin e Shtetit për krijimin e Qeverisë së Përkohshme, të cilën e konsideronte si një model të ngjashëm me atë të Titos.

Më 19 dhe 20 korrik 1944, Sekretari i Shtetit Cordell Hull u dha përgjigje kërkesave kryesore që iu adresuan qeverive aleate nga Kongresi i Përmetit.<sup>18</sup> Në telegramet që ai u dërgoi përfaqësuesve politikë të SHBA, Murphy dhe Brandt, pranë Shtabit Aleat të Mesdheut në Itali, theksonte se ‘parimet dhe konsideratat ushtarake në këtë fazë ishin shumë të rëndësishme’. Hull u bënte të qartë atyre që të përqendroheshin vetëm tek problemet ushtarake dhe të mos ngatërroheshin me problemet e natyrës politike. Politika amerikane, theksonte sekretari Hull, nuk kishte si qëllim të favorizonte ndonjë marrëveshje politike ndërmjet LNÇ dhe Kupit, përveçse luftës kundër gjermanëve. Aleatët donin që t’i aktivizonin e t’i bashkonin grupet aktive të rezistencës në Shqipëri, në luftë për çlirimin e vendit dhe t’i afronin sa të mundnin në rrethanat kur lufta po shkonte drejt fundit. Në thelb, pavarësisht nga gjuha diplomatike, kërkesa e dalë nga Kongresi për njohjen e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar dhe tërheqja e misioneve aleate [në fakt britanike] nga Abaz Kupi nuk gjeti mbështetje.

Telegrami i Sekretarit Amerikan të Shtetit nuk e refuzonte hapur njohjen e qeverisë së FNÇ, por logjika e fakteve atje të çonte. Ai dhe qeveria amerikane e konsideronin të parakohshëm krijimin e Qeverisë së Përkohshme në këtë kohë, ndërkohë që kishin shumë rezerva për përmbajtjen e saj. Qeveria amerikane, sipas Sekretarit të Shtetit, nuk ishte apriori kundër krijimit të një Qeverie të Përkohshme Shqiptare, por ajo e kushtëzonte krijimin e saj me çlirimin e vendit, gjë që ende nuk kishte ndodhur. Rezervat

<sup>17</sup> NARA, Roll 16, Telegram no. 875.01/6-2844, i këshilltarit të misionit amerikan në Algjer (Chapin) për Sekretarin e Shtetit, 28 qershor 1944, f. 273.

<sup>18</sup> *Po aty*, Roll 16, f. 275-276.

e saj kishin të bënin gjithashtu me shkallën e përfaqësimit në Kongres. Pjesëmarrësit në Kongres, sipas saj, nuk përfaqësonin të gjitha krahinat e vendit, ndërsa ushqenin dyshime për mënyrën e zgjedhjes së delegatëve që morën pjesë në të. Nuk mund të thuash se dyshimet e saj nuk kishin bazë, sepse vetëm një pjesë e vendit ishte e çliruar deri në këtë kohë. “Si për kushtet e ndërlikuara të luftës së armatosur, ashtu dhe për procedurën e fushatës elektorale, shkruan Kristo Frashëri, nuk ka dyshim se zgjedhja e delegatëve ishte e komanduar dhe jo demokratike. Në kushtet e okupacionit hitlerian, vazhdon ai më tej, nuk mund të pretendohet për një procedurë plotësisht demokratike”.<sup>19</sup>

Qeveria e FNÇ dhe fryma përjashtuese e Kongresit të Përmetit në këtë kohë binte ndesh me politikën e aleatëve anglo-amerikanë. Vendimi përjashtues i forcave të tjera në vend e ngushtonte bazën e rezistencës dhe dëmtonte frymën gjithëpërfshirëse, duke çuar në tkurrjen e FNÇ krahasuar me periudhën kur u hodhën themelet e tij në Konferencën e Pezës. Prandaj dy Aleatët Perëndimorë iu rikthyen idesë së Frontit të mëparshëm të dalë nga kjo konferencë. Ripërtëritja e saj ishte ftesë për zgjerimin e bazës mbështetëse të LNÇ në vend dhe rivendosjen e bashkëpunimit me forcat dhe organizatat e tjera aktive të rezistencës në Shqipëri.

Në thelb, Hull e refuzoi kërkesën e dalë nga Kongresi i Përmetit për njohjen e qeverisë së sapokrijuar. Përveç përmbajtjes së dyshimtë të programit të qeverisë së FNÇ dhe mënyrës së zgjedhjes së saj, Aleatët dyshonin se ajo nuk gëzonte mbështetjen e shumicës së popullit shqiptar. Dyshimi i Aleatëve të qeveria e krijuar dhe shkalla e mbështetjes së saj në vend, i çonte ata në një tjetër konkluzion: tek mungesa e garancive për stabilitet në të ardhmen e vendit, tek mbajtja e zgjedhjeve të lira e të ndershme etj. Mungesa e këtyre faktorëve do të çonte në përdorimin e presionit dhe të forcës, pra në diktaturë. Sekretari Hull u kërkonte atyre që të mos merreshin me pikëpamjet politike të grupeve të rezistencës në Shqipëri, por të fokusoheshin vetëm tek rezistenca e tyre kundër gjermanëve.

Sekretari Amerikan i Shtetit u tërhoqte vëmendjen përfaqësuesve politikë amerikanë në Shtabin e Forcave Aleate të Mesdheut, të cilët duhet të vinin në dukje diferencat e politikës amerikane me atë të Britanisë së Madhe në rajonin e Ballkanit. Amerikanët, theksonte ai, ndjekin në përgjithësi të njëjtën linjë politike, sikurse britanikët, por ai nuk dëshironte që politika e vendit të tij të njehsohej komplet me atë të britanikëve”. “Politika jonë, përmendte

<sup>19</sup> K. Frashëri, *Kongresi i Përmetit...*, f. 70.

Hull, nuk duhej të konceptohej si ndjekëse e thjeshtë e politikës britanike. Ai nuk dëshironte që populli shqiptar ta keqkuptonte pozicionin e qeverisë amerikane dhe ta konsideronte politikën e saj si kopje të politikës britanike. Hull u bënte të ditur përfaqësuesve amerikanë për Ballkanin e Shqipërinë, që të mos kënaqeshin me rolin e thjeshtë të vëzhguesit, por të përballeshin me rastet kur diskutohej për zgjidhjen e problemeve madhore dhe me të ardhmen e popujve të Ballkanit e të Shqipërisë.<sup>20</sup>

Pikëpamjet zyrtare të FNÇ për zhvillimet e ardhshme të Shqipërisë po qartësoheshin gjithnjë e më shumë. Në muajin shtator, Misioni i OSS i përcolli qendrës së vet në Washington, një artikull pa autor, të botuar në gazetën ‘Bashkimi’ [organ zyrtar i FNÇ] në një numër të veçantë të saj në korrik 1944 së bashku me komentet e tij.<sup>21</sup> Pavarësisht se artikulli i lartpërmendur nuk e përmbante emrin e autorit, përcjellësi i tij nënvizonte se ai është shkruar nga një anëtar i rëndësishëm i Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar. Duke pasur në konsideratë që Sejfulla Malëshova ishte emëruar në Përmet si ministër i propagandës, stilin dhe kulturën e tij marksiste të fituar gjatë qëndrimit të gjatë në Bashkimin Sovjetik, dhe shkrimet e tij të mëpasshme, mendojmë se artikulli është shkruar prej tij. Malëshova shihej si ‘teoricieni’ dhe projektuesi i zhvillimeve të ardhshme në vend. Konferencat e dhëna prej tij apo shkrimet në shtypin shqiptar, ndiqeshin me shumë vëmendje dhe në vazhdimësi nga përfaqësuesit e huaj.

Artikulli i botuar në një numër special të gazetës ‘Bashkimi’ në korrik 1944 titullohej: ‘Programi i Demokracisë Popullore dhe Dështimi i Demokracisë së vjetër’.<sup>22</sup> Përcjellësit e këtij dokumenti i bënin të qartë qendrës së vet në Washington: ‘Ky [artikulli] do të tregojë më tej që FNÇ ka një politikë dhe program të qartë dhe të përcaktuar, i cili kontribuon në koherencën e kësaj organizate’. Artikulli përvijon qartë programin e ardhshëm të zhvillimeve të Shqipërisë në rrugën e një ‘Shteti të Demokracisë Popullore’. Masat politike, ekonomike e shoqërore të tij dëshmojnë qartë se Shqipëria do të zhvillohej në rrugën e socializmit dhe jo të ‘Demokracive të vjetra’, të cilat kishin dështuar që të luftonin ardhjen në pushtet të fashizmit. Artikullshkruesi kritikon socialdemokracinë dhe socialistët evropianë në Itali e Gjermani, që i hapën rrugën ardhjes në pushtet të Musolinit dhe të Hitlerit. Kritikave nuk i shpëton as demokracia anglo-franceze e cila, sipas

<sup>20</sup> NARA, Roll 16, f. 276.

<sup>21</sup> *Po aty*, RG 226, Entry 16, Box. 1098, File 95542, pp. 1-10.

<sup>22</sup> *Po aty*, f. 3.

artikullshkruesit ‘fuqizoi bllokadën ndaj Republikës Spanjolle dhe solli triumfin e fashizmit në Spanjë’.<sup>23</sup>

Autori përmend parimet kryesore të Demokracisë Popullore, duke atakuar drejtpërdrejt parimet e demokracive perëndimore. Demokracia Popullore, shkruante autori, përfaqëson pushtetin politik, legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor të klasës punëtore. Sipas tij, në demokracitë e stilit të vjetër, pushteti ekzekutiv e legjislativ ishin të ndarë, ndërsa sovraniteti i popullit është i kufizuar, madje formal. Autori gjithashtu stigmatizon shkëputjen e deputetit nga populli, i cili gëzon të drejtën e imunitetit parlamentar, që mbron atë nga largimi nga detyra. Ai hedh idenë që i tërë sistemi nga baza në majë do të përbëhet nga personat e dalë nga radhët e FNÇ - besnikë të programit të tij. Në pikën 7 të artikullit thuhet se “Demokracia Popullore do luftojë të gjitha tendencat imperialiste brenda dhe jashtë Shqipërisë, duke përfshirë këtu edhe parullën e ‘Shqipërisë etnike’. Demokracia Popullore favorizonte sipas artikullshkruesit, krijimin e ‘Federatës së Demokracive Popullore të Ballkanit’, në të cilën të gjithë kombet do të kenë të drejta të barabarta’.<sup>24</sup>

Politika ekonomike e regjimit të ardhshëm të Demokracisë Popullore zë një vend të veçantë. Aty parashikoheshin pothuajse të gjitha ato masa që u morën në këtë fushë në vitet e para të pasçlirimit në Shqipëri, duke përfshirë shtetëzimet, konfiskimet e pronave të ‘tradhtarëve të luftës’, vendosjen e kontrollit punëtor mbi industrinë, reformën agrare, taksën progresive, shtetëzimet pa shpërblim etj. Në program përmenden gjithashtu një varg masash në fushën sociale, kulturore e arsimore. Autori shkruan pa droje, se e drejta për të vendosur në Shqipëri një regjim të këtij karakteri buron nga ‘Lufta Nacionalçlirimtare, nga kontributi i popullit tonë në këtë luftë’.<sup>25</sup> Analiza e artikullit të mësipërm të çon në konkluzionin, se në Shqipëri po projektohej të vendosej një regjim i ndryshëm nga regjimet e mëparshme, në thelb komunist.

Një analizë të gjerë e të kujdesshme u bëri vendimeve të Kongresit të Përmetit përfaqësuesi politik i OSS në Departamentin e Shtetit [DSH], Philip Adams. Më 3 gusht, ai i paraqiti shefit të Divizionit të Çështjeve të Evropës Jugore një memorandum të posaçëm për Shqipërinë.<sup>26</sup> Memorandumi i përgatitur prej tij kishte si qëllim *së pari*, që ta nxiste DSH

<sup>23</sup> *Po aty*.

<sup>24</sup> *Po aty*, f. 6.

<sup>25</sup> *Po aty*, f. 8.

<sup>26</sup> NARA, M 1211, Roll 15, 875.00/9-544, 5 shtator 1944.

të paraqiste një deklaratë të re për Shqipërinë, duke pasur në konsideratë ndryshimet që kishin ndodhur në këtë vend, pas dhjetorit të vitit 1942, *së dyti*, që qeveria amerikane t'u jepte përgjigje fjalëve dhe opinionit të përhapur tek shqiptarët, se 'Amerika kishte qëndruar indiferente ndaj fatit të tyre; dhe *së fundi*, deklarata e re e DSH do ta vinte nën presion LNÇ dhe do t'i hapte sytë popullit shqiptar, se grindjet dhe fraksionet po e rrezikonin të ardhmen e tyre.<sup>27</sup>

Analiza e karakterizime më të plota e më të shumta Adams i kushtonte Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe qeverisë së krijuar prej saj në Përmet. Rezervat e tij kishin të bënin me frymën ideologjike komuniste të bërthamës së saj udhëheqëse dhe politikës së saj përjashtuese ndaj forcave nacionaliste. Adams nuk mendonte se LNÇ ishte e vetmja forcë që, luftonte kundër gjermanëve dhe e vetmja forcë që përfaqësonte shqiptarët. Në mbështetje të tezës së tij ai sillte si argument, faktin që lëvizja partizane ishte më e fuqishme në gjysmën jugore të Shqipërisë, ndonëse pranonte se së fundmi ajo po avanconte më tej në territorin shqiptar. 'Mbi bazën e informacioneve të tanishme, theksonte ai, Departamenti i Shtetit nuk është i bindur, që LNÇ është e vetmja forcë përfaqësuese e vullnetit të lirë të popullit shqiptar, siç pretendon ajo'. Adams nuk kishte asnjë lloj ndjeshmërie pozitive ndaj Ballit Kombëtar dhe në një farë mase edhe ndaj Legalitetit. Por, atij i ishte dukur shumë shqetësuese një thënie e dalë nga Kongresi i Përmetit, sipas së cilës, 'LNÇ do të shkatërronte plotësisht të gjitha 'klikat e tjera reaksionare në të ardhmen'.<sup>28</sup> Me 'klikat reaksionare' gjykonte ai, LNÇ, duket se nënkupton të gjitha partitë dhe grupet e tjera, të cilat kundërshtonin programin e saj. Ajo, vazhdonte ai më tej, e refuzoi bashkëpunimin me zogistët, të cilët i denoncoi në Kongres me terma ekstremë. Në të njëjtën kohë, LNÇ e klasifikon veten si një trupë me ambicie të kufizuara për të vendosur formën e qeverisë para mbarimit të luftës. Por në DSH, sipas Adams kishin një vlerësim tjetër nga ai i LNÇ për të ashtuquajturit 'grupe reaksionare'. Sipas diplomatit amerikan, në këtë kategori mund të përfshiheshin grupe qytetarësh të ndershëm, të cilët nuk e pëlqenin komunizmin, të cilëve nuk duhej që t'u mohohet e drejta për të shprehur opinionet e veta, pa u rënë askush më qafë. Është e qartë, theksonte ai, se nëse një vend rrënohet jo vetëm nga armiku, por edhe nga grindjet ndërmjet kundërshtarëve politikë, zëri i njerëzve të zakonshëm nuk

<sup>27</sup> *Po aty.*

<sup>28</sup> NARA, RG 226, File 82715, Box 966, f.12. Raport mbi Kongresin e Përmetit 24-28 maj 1944, 6 korrik 1944.

mund të shprehet lirisht. Për këtë arsye shtonte ai më tej, zëri i veçantë duhet të dëgjohet, nëse Shqipëria do të përfitojë nga një vend kampion i demokracisë, siç ishin SHBA.

Pavarësisht nga arsyet e mosmarrëveshjeve ndërmjet fraksioneve me vështrime të ndryshme ideologjike, mungesa e një qeverie të njohur të shqiptarëve nga Aleatët i penalizonte ata dhe i vendoste në pozita inferiore krahasuar me popujt e tjerë të Ballkanit. Shqiptarët nuk kishin asnjë qeveri të njohur, as jashtë dhe as brenda vendit, e cila do t'i përfaqësonte në konferencat ndërkombëtare për periudhën e luftës. Por, duket se ky fenomen do të vazhdonte edhe pas mbarimit të saj. “Në këtë aspekt, shkruante Adams, Shqipëria është e veçantë ndërmjet të gjitha vendeve të Evropës”. Ajo nuk ka mundësi që të mbrojë veten e saj, ndërkohë që SHBA njihen si vend kampion për mbrojtjen në të shkuarën të çështjes shqiptare. “Unë mendoj, shkruante diplomati amerikan, duke i referuar deklaratës së Hull të vitit 1942, është e sigurt që të thuhet se në proporcion me masën e saj, Shqipëria ka ofruar po aq rezistencë kundër armikut, dhe e ka pësuar po aq sa edhe çdo shtet tjetër i Evropës së pushtuar”. Adams mendonte se shqiptarëve i duhej një qeveri e njohur nga Aleatët që do t'i përfaqësonte ata gjatë kohës së luftës. Por ai e gjykonte të vështirë krijimin e një qeverie të tillë, duke patur parasysh grindjet dhe mosmarrëveshjet ndërmjet forcave politike e ushtarake brenda e jashtë Shqipërisë. Asnjë prej tyre mendonte Adams, nuk do ishte në gjendje të krijonte një qeveri përfaqësuese. ‘Mund të thuhet, shkruante ai, se në kohën e tanishme Balli Kombëtar, i cili ka pasur imazh të shkëlqyer në luftimet e shkuara kundër italianëve, tani po bashkëpunon paturpësisht me gjermanët, dhe është afruar kaq shumë me qeverinë kuislinge, sa që është pothuajse e pamundur që të bësh ndonjë dallim ndërmjet të dyve’. Për Abaz Kupin dhe Legalitetin ai shprehej: ‘Partia Zogiste e Kupit (Bazi i Canës), burrit që mbrojti heroikisht Durrësin kundër pushtuesve italianë në vitin 1939, është seriozisht e kompromentuar për shkak të mungesës së gatishmërisë për të luftuar me gjermanët dhe të marrëdhënieve të tij të afërta me qeverinë kuislinge’.<sup>29</sup>

Adams merrej edhe me problemin e qeverisë shqiptare të pasluftës dhe mënyrën e zgjedhjes së saj. Sipas koncepteve të tij më e rëndësishme se sa natyra e qeverisë që do të vinte në pushtet ishte mënyra e zgjedhjes së saj. ‘Dëshira e DSH, është që të gjejë mirëkuptimin e popullit shqiptar, i cili ka të drejtë ligjore që të ketë ekzaktësisht atë lloj qeverie për periudhën e pasluftës,

<sup>29</sup> *Po aty*, M 1211, Roll 15, 875.00/9-544, 5 shtator 1944.

që do të dalë nga zgjedhjet e lira dhe nga plebishiti, çfarëdo që të jetë, regjim komunist, republikan apo monarkik’.<sup>30</sup>

Në këto rrethana, Adams i rekomandoi DSH si zgjidhje - krijimin e një qeverie të përbërë kryesisht nga elementë shqiptarë në SHBA, të cilët mund të zhvendoseshin në Shqipëri në një kohë të caktuar. Departamenti i Shtetit nuk e inkurajoi as krijimin e një qeverie të shqiptarëve në mërgim, dhe as njohjen e qeverisë së dalë nga Kongresi i Përmetit.<sup>31</sup>

Në DSH mendonin se zgjidhja më e mirë në rrethanat kur Shqipëria po shkonte drejt çlirimit të saj do të kishte qenë krijimi i një qeverie koalicioni brenda vendit, ndonëse ishin të qartë që vendimet e Kongresit të Përmetit binin ndesh me këtë ide. As LNÇ dhe askush tjetër brenda dhe jashtë vendit nuk mund të shprehte e vetme vullnetin e popullit shqiptar. “Qeveria e përkohshme e krijuar së fundi nga LNÇ, shkruante J. C. Campbell në korrik 1944 duke komentuar opinionet e Philip Adams, nuk pretendon të jetë qeveri e gjithë shqiptarëve, por vetëm e zonave çliruara”.<sup>32</sup> Rrugëzgjidhja më e mirë do të ishte që LNÇ ta linte derën e hapur për të bashkëpunuar me forcat e tjera.

Më 12 gusht 1944, Murphy njoftonte Sekretarin Hull, se Shtabi i Forcave Aleate (AFHQ) kishte udhëzuar Forcën Ajrore të Ballkanit (British Air Force-BAF) që të refuzonte me politesë, por me vendosmëri kërkesën e LNÇ për njohjen e Komitetit Antifashist, si qeveri *de facto* e Shqipërisë.<sup>33</sup> As britanikët dhe as amerikanët nuk ishin të gatshëm t’i ofronin njohje qeverisë shqiptare të dalë nga Kongresi i Përmetit. Britanikët ishin treguar të rezervuar më herët. Pavarësisht nga frazat dhe mënyra diplomatike e refuzimit të njohjes së qeverisë së dalë nga Kongresi i Përmetit, në thelb ai gjykohej si akt i parakohshëm, i cili nuk i përfaqësonte të gjithë shqiptarët.<sup>34</sup>

<sup>30</sup> *Po aty*.

<sup>31</sup> NARA, Roll 15, 875.00/9-544. Koment i Divizionit të Çështjeve të Evropës Jugore në DSH, në lidhje me memorandumun e zotit Adams për Shqipërinë, 5 shtator 1944.

<sup>32</sup> *Po aty*, RG 226, Roll 16, pp.1-2. Campbell [Sothorn Division in Department of State-Divizioni i Jugut në Departamentin e Shtetit], 13 korrik 1944.

<sup>33</sup> *Po aty*, RG 59. Telegram no. 875.01/8-1244, i Robert D. Murphy (këshilltar politik i SHBA në AFHQ) për Hull, 12 gusht 1944, f. 276.

<sup>34</sup> NARA, RG 226, Memorandum i R.P. Joice për J. Green, W. Ross dhe H.T. Fultz, sekret, më 24 korrik 1944.

## **Politika e re e britanikëve dhe pajtimi me të i qeverisë amerikane**

Qëndrimi i dy Aleatëve Perëndimorë do të merrte kthesë të madhe më 5 tetor 1944, pas promemories që Sekretari britanik i Shtetit, Anthony Eden i përcolli Kryeministrit Churchill. Thelbin e politikës së re e përbënte, *së pari*, mbështetja e plotë për LNC, braktisja dhe lënia në fatin e tyre të forcave nacionaliste dhe *së dyti*, zgjerimi i bazës qeverisëse të FNC, duke përfshirë në të elementë nacionalistë të papërlyer me gjermanët.<sup>35</sup>

Ndryshimi i situatës në favor të LNC dhe humbja e forcave nacionaliste u reflektuan në qëndrimin e sekretari Hull, i cili më 5 tetor 1944 shfaqte pikëpamjen se, Kupi dhe forcat nacionaliste shqiptare nuk e meritonin të ndihmoheshin më me furnizime ushtarake nga Aleatët, për shkak të qëndrimit inaktiv të tyre ndaj armikut të përbashkët. Por, nga ana tjetër, në mënyrë të nënkuptuar fliste edhe për ndihmat ushtarake aleate që përfitonte LNC, të cilat po përdroreshin nga partizanët shqiptarë jo vetëm për të luftuar gjermanët, por edhe kundërshtarët e tyre nacionalistë brenda vendit. Pavarësisht nga rezervat e misionëve aleate ndaj përdorimit të një pjese të furnizimeve të tyre për të likuiduar kundërshtarët nacionalistë, në vjeshtën e vitit 1944 mbizotëronte gjykimi se LNC ishte e vetmja forcë që luftonte realisht kundër gjermanëve.

Eden e pranonte mbizotërimin e forcave të FNC në Shqipëri. Ai i krahasonte këto të fundit me partizanët e Titos dhe me ata të EAM-it në Greqi. Kjo organizatë, përmendte ai, kishte ofruar rezistencë serioze si ndaj italianëve ashtu edhe ndaj gjermanëve, ndërsa nënvizonte se furnizimet aleate të kohëve të fundit kishin shkuar tërësisht në adresë të saj. Si forcë tjetër të rezistencës, sekretari i Jashtëm britanik përmendte edhe 'Lëvizjen e Legalitetit', por, ai nuk harronte të shtonte se 'kjo organizatë kishte muaj të tërë që nuk kishte ndërmarrë ndonjë aksion kundër gjermanëve'.<sup>36</sup> Kupi, i shkruante Eden kryeministrit Churchill, personalisht nuk kishte bashkëpunuar me armikun, por ai kishte pasur kontakte me nacionalistët, duke përfshirë edhe ish anëtarë të qeverisë kukull. Si Kupi ashtu edhe nacionalistët e tjerë vazhdonin t'i siguronin Aleatët se do të luftonin kundër gjermanëve, por deri tani kishin ndërmarrë vetëm disa aksione të vogla. Ata

---

<sup>35</sup> *The National Archives*, London (më tej: TNA), Foreign Office (më tej: FO) 371/43555. Anthony Eden për Winson Churchill, 5 tetor 1944, f. 111.

<sup>36</sup> *Po aty*.

donin ndihma nga Aleatët me qëllim që të vendosnin kontrollin në zonat e tyre, në mënyrë që pas tërheqjes së gjermanëve të diskutonin për vendosjen e kontrollit në Shqipëri.

Eden e konsideronte jugun e Shqipërisë si bastionin kryesor të FNÇ, ndërsa Shqipërinë Qendrore e Veriore i cilësonte si ‘shumë primitive dhe pak të hapura ndaj ekstremit të krahut të majtë’. Për sekretarin e Jashtëm britanik nuk ishte surprizë, që forcat e FNÇ kishin hasur pak rezistencë gjatë kalimit të tyre në veriun e Shqipërisë. Eden vinte në dyshim aftësitë e Abaz Kupit dhe të nacionalistëve në këtë kohë, për të ndaluar forcat partizane nga kontrolli i plotë i vendit. Por, edhe forcat aleate gjykonte Eden, nuk mund ta ndalonin marshimin e forcave partizane në territoret e nacionalistëve shqiptarë.

Pasi analizonte me kujdes situatën e Shqipërisë, sekretari britanik sugjeronte edhe rrugëzgjdhjen e saj, sigurisht duke respektuar interesat e Britanisë së Madhe. Ai i shkruante Churchill-it: *“Interesat tona në Shqipëri janë të kufizuara, por ne kemi premtuar që ta rimëkëmbim Shqipërinë e pavarur pas luftës, dhe për këtë arsye ne do të kërkojmë rivendosjen e ligjit dhe rregullit, dhe në mënyrë të arsyeshme një qeveri të qëndrueshme. Do të ishte kundër interesave tona një Shqipëri që do të kalonte plotësisht në influencën sovjetike, dhe për këtë arsye do të ishte e rrezikshme që të vijë në pushtet një qeveri e tillë”*. Sekretari britanik arrinte në përfundimin se në rrethanat e krijuara FNÇ do të kontrollonte tërë Shqipërinë, ndërsa britanikëve do t’u duhej që të fuqizonin pozicionin e tyre rreth kësaj force, me qëllim që të kompensojnë influencën ruse. Këtë propozim ai ia kishte përcjellë më parë edhe Harold M. Macmillan.\*

Politika e propozuar nga Eden përbënte risi për FO, sepse deri në këtë kohë, së paku teorikisht, ajo kishte mbështetur të gjitha grupet aktive të rezistencës shqiptare, pavarësisht nga dallimet ideologjike. Thelbin e politikës së re e përbënte braktisja përfundimtare e forcave nacionaliste dhe mbështetja tërësore ndaj FNÇ. Në pikën e fundit të promemories, Eden merrej me faktorin Zog dhe rolin e tij në të ardhmen e vendit. Ai gjykonte se kthimi i Zogut do të ishte i pamundur, për shkak të vendimeve të marra nga Kongresi i Përmetit, por edhe të influencës së pakët të tij brenda vendit.

---

\* Maurice Harold Macmillan ka patur poste të larta në qeveritë britanike. Në vitet 1957-1963 ai ishte Kryeministër i qeverisë britanike, ndërsa në kohën që përmendet në tekst ai shërbente si ministër Rezident në Mesdhe dhe komunikonte direkt me Winston Churchill, pa ndërmjetësimin e Sekretarit të Jashtëm-Anthony Eden.

Sidoqoftë, karta e Mbretit Zog nuk hidhej poshtë plotësisht. Zogu mund të riaktivizohej nëse qeveria e FNÇ do të përmbysej.

Politika e re e britanikëve iu bë e njohur edhe aleatëve amerikanë, të cilët fillimisht u shfaqen të rezervuar, por shpejt edhe ata do të bashkoheshin me të. Për momentin, politika e mbështetjes tek më i forti dukej premtuese. Dy Aleatët Perëndimorë, të paraprirë nga britanikët, u munduan ta shfrytëzonin politikën e re për të zgjeruar bazën qeverisëse të LNÇ, duke e modifikuar e zbutur qeverinë e saj. Qeveria ekzistuese mund të bëhej më përfaqësuese, nëse do të përfshinte brenda saj elementë nacionalistë, të cilët kishin dhënë prova se kishin luftuar me pushtuesit gjermanë. Propozimi i Aleatëve Perëndimorë në pamje të parë dukej i pranueshëm për FNÇ, sepse ajo do të vazhdonte sërish të përfaqësonte shumicën në qeverinë e krijuar prej saj. Propozimi i ri në thelb përbënte një lloj tërheqjeje të Aleatëve, sepse tashmë nuk këmbëngulej më për të përfshirë në qeveri elementë të opozitës së gjerë, siç ishin përfaqësuesit e Ballit Kombëtar apo të emigracionit shqiptar jashtë vendit, por vetëm disa emra të veçantë nacionalistësh me reputacion pozitiv për sytë e popullit shqiptar. Një qeveri që do të kishte mbështetjen e popullit do të ishte në gjendje që t'u qëndronte sfidave të ardhshme politike e ekonomike. *'Doktrina politike e britanikëve dhe amerikanëve, presupozon që siguria politike mbështetet tek vullneti i popullit, dhe si rrjedhim të gjitha qeveritë e reja të krijuara gjatë luftës, duhet të kenë mbështetjen e tij'*.<sup>37</sup> Britania e Madhe dhe SHBA i kushtuan vëmendje të madhe procesit të krijimit dhe të njohjeve *de jure* të qeverive të reja në Evropë. Parimisht ata donin të garantoheshin *së pari*, që të mos kishte opozita potencialisht më të forta se qeveritë në pushtet, dhe *së dyti*, që opozitat të mos ishin të shtypura, ndërsa qeveritë duhej të jepnin siguri se do të mbanin zgjedhje të lira. Vështirë të pohosh se këto dy parime gjetën vend në Shqipëri.

Në vjeshtën e vitit 1944, lufta në Shqipëri po shkonte drejt fundit. Gjermanët kishin shpallur tërheqjen e trupave ushtarake, ndërkohë që më 26 tetor si qeveria kuislinge ashtu edhe regjenca shqiptare kishin dhënë dorëheqjen. Fitorja e FNÇ ishte thjesht çështje kohe. Problemi i të ardhmes së Shqipërisë dhe i qeverisjes së saj pas çlirimit po dilte në plan të parë, ndërsa detyrat ushtarake dalëngadalë po ua linin vendin detyrimeve politike. Aleatët Perëndimorë në rrethanat ekzistuese gjyktonin si zgjidhjen më të mirë

<sup>37</sup> TNA, *Cabinet Office Files* (më tej: CAB) 106/459. "The Civil Relief Operations of Anglo-American Forces in Balkans-Operacionet për Ndihma Civile të Forcave Anglo-Amerikane në Ballkan", Part VII, 31 mars 1946.

krijimin e një qeverie gjithë përfaqësuese. Por, një alternativë e tillë ishte e vështirë të arrihej sepse Partia Komuniste Shqiptare dhe Enver Hoxha nuk donin ta ndanin pushtetin me forca e individë jashtë radhëve të FNC, ndërkohë që Aleatët Perëndimorë nuk kishin plane e forca ushtarake për të zbarkuar në Shqipëri, të cilat do ta ndryshonin situatën në favor të tyre. Në këto kushte, ata i kërkuan FNC që të zgjeronte bazën e vet qeverisëse, duke përfshirë në qeveri disa elementë nacionalistë, me kontribute në luftë, por edhe me prirje properëndimore. Zgjerimi i qeverisë me elementë nacionalistë e proaleatë u kërkuua me ngulm për qeverinë e dalë nga mbledhja e Beratit. Kjo kërkesë nuk u tolerua nga dy Aleatët Anglo-Amerikanë të luftës dhe një lloj detyrimi për të njohur qeverinë e dalë nga mbledhja e Beratit. Por, udhëheqja komuniste e Shqipërisë nuk e pranoi këtë kërkesë të Aleatëve. Ajo u mundua të njolloste çdo figurë nacionaliste jashtë radhëve të Frontit, pavarësisht nëse ata kishin bashkëpunuar apo jo me pushtuesit. Kupi dhe Legaliteti ishin baltosur më herët, ndërsa me vëllezërit Kryeziu u ndoq një taktikë tjetër. Atyre iu kërkuua të përfshiheshin brenda radhëve të FNC, e cila nuk u pranua prej tyre. Sidoqoftë, në qeverinë e dalë nga mbledhja e Beratit ishin përfshirë disa ministra me profil nacionalist të cilët ishin bërë pjesë e FNC, më herët. Ndër të rikonfirmuarit ishte edhe Gjergj Kokoshi.

Në kushtet kur opozita jashtë radhëve të FNC kishte pak ose aspak shanse për sukses dhe kur krijimi i një qeverie koalicioni dukej gati i pamundur, Aleatët u kushtuan vëmendje edhe disa figurave të rëndësishme brenda udhëheqjes së FNC, të cilët me kalimin e kohës mund të ktheheshin në burim mosmarrëveshjesh brenda radhëve të tij. Në një listë të përgatitur nga forca 399, në nëntor 1944, gjenden emrat e disa udhëheqësve me peshë të LNC, të tillë si: Myslim Peza, Mehmet Shehu, Haxhi Lleshi, Nexhip Vinçani e Islam Radovicka.<sup>38</sup> ‘Ndonëse ende nuk gjendet ndonjë fakt që të shprehë realisht afeksionin probritanik të tyre, dokumenti thekson pa ekuivokë se, ata janë kundër organizatës dhe politikës së tanishme të Partisë, dhe se kjo e fundit ishte plotësisht e ndërgjegjshme për prirjet e tyre’. Nexhip Vinçani dhe Islam Radovicka konsideroheshin si udhëheqës probritanik,

<sup>38</sup> NARA, Roll 16, top sekret. “Vlerësime të Shtabit të Forcës 399 mbi situatën në Shqipëri”, 10 nëntor 1944; TNA, *Air Ministry and Ministry of Defence* (më tej: AIR) 20/8407, top sekret. “Vlerësime të Shtabit të Forcës 399 mbi situatën në Shqipëri”, 11 nëntor 1944.

ndërsa tre të tjerët si njerëz me influencë, por individualistë dhe me prirje kundër Partisë Komuniste të Shqipërisë.<sup>39</sup>

Të tjerë oficerë të misioneve aleate e zgjerojnë listën e personave opozitarë, të hapur apo të maskuar ideologjikë, brenda radhëve të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, duke përfshirë në të edhe emrat e Mustafa Gjinishit e të Mustafa Kaçaçit, për të cilët flitej në mënyrë të nënkuptuar se ishin eliminuar në periudhën gusht-shtator 1944 nga vetë udhëheqja e lartë komuniste.<sup>40</sup>

Për të qartësuar dhe përcaktuar politikën që do të ndiqej ndaj FNÇ dhe qeverisë së tij të përkohshme, Seksioni i Evropës Jugore, pranë Departamentit të Shtetit më 7 tetor të vitit 1944, i kishte paraqitur qeverisë amerikane një memorandum të posaçëm<sup>41</sup>. Memorandumi përmban një numër çështjesh për pikat e forta të njohjes dhe mosnjohjes së qeverisë shqiptare. Në 16 prej tyre kundërshtojë ideja e njohjes së qeverisë shqiptare nga qeveria amerikane, ndërsa në 20 të tjera mbështetë njohja e saj. Sidoqoftë, ky memorandum arrinte në përfundimin se, qeveria amerikane nuk do t'i akordonte njohje qeverisë aktuale, por as do t'u jepte mbështetje tentativave të grupeve të tjera jashtë apo brenda vendit. Mospranimi i këtyre kushteve do të çonte në mosnjohjen e asnjë qeverie të krijuar nga shqiptarët. Memorandumi nuk harronte të përmendte se do të ishte vetë populli shqiptar ai që duhej të përcaktonte si formën e qeverisjes ashtu edhe qeverinë që ai dëshironte, në përputhje me vendimet e Kartës së Atlantikut.

### **Qeveria e Beratit: Fati i kërkesës për njohjen e saj nga SHBA**

Nga mbledhja apo Kongresi i Beratit [siç cilësohet në dokumentacionin britanik e amerikan] iu dërgua mesazh për njohjen e qeverisë demokratike tre përfaqësuesve më të lartë të Aleatëve të Mëdhenj, por edhe peshkop Fan Nolit dhe Konstandin Çekrezit. Enver

<sup>39</sup> TNA, AIR 20/8407, top sekret. “Vlerësime të Shtabit të Forcës 399 mbi situatën në Shqipëri”, 11 nëntor 1944. Për Mehmet Shehun shkruhej se ishte ‘person ambicioz dhe mendjemadh, që është lënë nga partia për ca kohë në nivele të ulta. Ai është pa dyshim figura më e rëndësishme dhe më e respektuar brenda Lëvizjes. Së fundi, ai ka qenë në varësi të Ndreut [Dali]-komandantit të Korpusit të Parë. Mehmeti është komunist, por ambicia e tij personale e kapërcen besnikërinë e tij ndaj partisë’.

<sup>40</sup> Erald Kapri, *Sekretet e Luftës. Shqipëria tjetër në dokumentet britanike*, Instituti i Studimeve Historike ‘Lumo Skëndi’, Tiranë: 2017, f. 216.

<sup>41</sup> NARA, M 1211, Roll 16, 16 tetor 1944.

Hoxha më 20 tetor foli për krijimin e ‘qeverisë demokratike të Shqipërisë’ dhe paraqiti jo zyrtarisht kërkesën për njohjen e saj nga qeveritë e tre Aleatëve të Mëdhenj. “Qeveria jonë demokratike, theksoi ai, do të kërkojë prej Aleatëve tanë të Mëdhenj, Anglisë, BS e SHBA, dhe më tej të Jugosllavisë e të gjithë shteteve të tjerë aleat e miq të Bllokut Antifashist, njohjen e saj, si të vetmen qeveri të popullit shqiptar”.<sup>42</sup> Kërkesa për njohjen e saj nga vendet aleate, deklaronte Enver Hoxha, do të ishte një ndër aktet e para të qeverisë së tij në fushën ndërkombëtare pas çlirimit të plotë të vendit.

Kërkesa e dalë nga mbledhja e Beratit për njohjen e Qeverisë Demokratike, në të cilën kishin asistuar edhe përfaqësuesit ushtarakë të tre Aleatëve të Mëdhenj i vuri në lëvizje qeveritë e tyre. Më 26 tetor 1944 Alexander Kirk njoftonte DSH nga Caserta për këtë ngjarje: ‘Komiteti Antifashist do të jetë Qeveria e re Demokratike e Shqipërisë, e cila do të administrojë vendin deri sa të zgjidhet Asambleja Kushtetuese. Komiteti, shtonte ai, përbëhet nga 30 anëtarë’.<sup>43</sup> Më tej, ai informonte se, kërkesën për njohjen e qeverisë së re do ta paraqiste ministri i Punëve të Jashtme - Dr. Omer Nishani. Ai shkruante gjithashtu edhe për zgjedhjen e kryeministrit të kësaj qeverie - Enver Hoxhës, pa harruar të komentonte se zgjedhja e tij ishte shoqëruar me ‘brohoritje të çmendura, që vazhduan gjatë gjithë natës’.<sup>44</sup>

Deklarata për liritë dhe të drejtat e qytetarëve e miratuar nga Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar në mbledhjen e Beratit u prit mirë nga Aleatët Perëndimorë. Por, këshilltari politik i SHBA tregojë skeptik për nenin që kishte të bënte me votimin sekret. Ai mendonte se nuk kishte garanci për zbatimin e tij dhe me kalimin e kohës ai mund të lihej mënjanë.<sup>45</sup>

Kërkesa për njohjen e qeverisë së dalë nga mbledhja e Beratit, do të ndeshte në refuzimin e qeverive aleate. Ajo do të pësonte fatin e kërkesave të paraqitura më parë nga Mbreti Zog, nga ‘Vatra’ dhe nga ‘Shqipëria e Lirë’. Qeveritë e Britanisë së Madhe, të SHBA dhe BS e

<sup>42</sup> AQSH, F. 40 (Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar), V. 1944, D. 23, fl. 17. Nga raporti i Enver Hoxhës, 20 tetor 1944.

<sup>43</sup> NARA, Roll 16, telegram no. 875.01/102644. Kirk për Sekretarin e Shtetit, 26 tetor 1944.

<sup>44</sup> *Po aty*.

<sup>45</sup> NARA, Roll 16. Këshilltari politik i SHB pranë Shtabit të Forcave Aleate për Sekretarin e Shtetit, nr. 916, 18 nëntor 1944.

quajtën të parakohshme njohjen e qeverisë së Beratit. Veçanërisht e vendosur kundër njohjes së ndonjë qeverie shqiptare të krijuar në Berat u tregua qeveria britanike. Britanikët si edhe herët e tjera i paraprinë aksionit të Aleatëve të Mëdhenj për të mos njohur qeverinë e Beratit. FO pati disa komunikime me DSH për këtë problem. Në memorandumun që ajo i dërgoi DSH më 3 nëntor 1944, përmes ambasadës së vet në Washington thuhej: “Qeveria e Madhërisë së Tij, në situatën e tanishme të paqartë në Shqipëri, nuk e propozon njohjen e Qeverisë së Përkohshme të krijuar nga Fronti NÇL. Ambasada britanike, thuhej më tej, është udhëzuar që të shprehë shpresën, se Qeveria e Shteteve të Bashkuara do të jetë në të njëjtën mendje”.<sup>46</sup>

Më 21 dhjetor 1944, Enver Hoxha me cilësinë e kryeministrit të Shqipërisë u propozoi zyrtarisht Aleatëve të Mëdhenj të njihnin Qeverinë Demokratike të Shqipërisë. Kërkesa zyrtare për njohjen e qeverisë së përkohshme iu drejtua Presidentit Roosevelt, Kryeministrit Churchill dhe Mareshalit Stalin.<sup>47</sup> Në notën e formuluar nga Enver Hoxha theksohej, se njohja do të ishte plotësisht e merituar, sepse FNÇ ishte i vetmi grup që i kishte rezistuar efektivisht Fuqive të Boshtit në Shqipëri, se formacionet partizane e kishin çliruar vendin pa ndihmë nga jashtë, se qeveria e FNÇ kontrollonte plotësisht të gjithë vendin dhe së fundi, se nuk ekzistonte asnjë qeveri tjetër shqiptare e formuar brenda ose jashtë vendit.

Si zakonisht edhe këtë herë ishte qeveria britanike që u shpreh e para. Ajo i propozoi qeverisë amerikane që së bashku ta refuzonin njohjen e qeverisë shqiptare. Në të njëjtën ditë që kryeministri shqiptar paraqiti kërkesën për njohje, në FO u paraqit një dokument i posaçëm nga zoti Pink - një zyrtar i lartë i këtij dikasteri. Dokumenti në formë drafti i titulluar: “Relacionet me Enver Hoxhën dhe F. N. Ç”, paraqiste arsyet reale të refuzimit të britanikëve, por edhe idenë për t’u njohur me opinionin e qeverisë amerikane, në mënyrë që të dy shtetet të ecnin me të njëjtin hap.<sup>48</sup> Relacioni i tij shprehte idenë se tashmë në Shqipëri kishin

<sup>46</sup> *Foreign Relations of United States of America* (më tej: *FRUS*), Diplomatic Papers, *The British Commonwealth and Europe*, Volume III, Washington: United States Government Printing Office, 1965. Memorandum i ambasadës britanike për DSH, nr.875.01/11-344, 3 nëntor 1944, f. 282.

<sup>47</sup> *NARA*, RG 59, Box 2036, p.1; *AQSh*, F. 890, V. 1945, D. 25, fl. 1; Nichola J. Costa, *Albania: A European Enigma*, New York: Columbia University Press, 1995, p. 116.

<sup>48</sup> *TNA*, FO 371/143556, Viti 1944. Relacion i Pink, ‘Shqipëria, Marrëdhëniet me Enver Hoxhën dhe F.N.Ç’, 21 dhjetor 1944.

ardhur në fuqi komunistët, dhe se FNÇ nën udhëheqjen e të ‘vetëkënaqurit kolonel-gjeneral Enver Hoxha’ kontrollonte realisht vendin. Ai mendonte se nuk duhej vonuar njohja e qeverisë së përkohshme të Hoxhës, por as t’i jepej përshtypja se Aleatët po vraponin pas tij. Pink ishte i pakënaqur me trajtimin e oficerëve të Ndërlidhjes Ushtarake në Shqipëri dhe me situatën në përgjithësi, e cila ishte e njëjtë me atë që ata kishin ndeshur në Jugosllavinë e Titos. “Mua më duket, shkruante Pink, se udhëheqësit e F.N.Ç frymëzohen dhe kërkojnë këshilla politike nga rusët, ndërsa nga ne furnizime dhe ar. Ashtu si në Jugosllavi, ata u janë më shumë mirënjohës të parëve [rusëve] se sa të dytëve” [anglezëve e amerikanëve].<sup>49</sup>

DSH i ktheu përgjigje qeverisë britanike, duke rikonfirmuar qëndrimin e saj të mëparshëm. “DSH pajtohet me pikëpamjen e qeverisë britanike, thuhej në memorandum, se çdo kërkesë për njohjen e qeverisë provizore të krijuar në Berat, që mund të bëhet në këtë kohë, nuk do të jepet”.<sup>50</sup> DSH do ta jepte njohjen *de jure* për qeverinë shqiptare, nëse ajo do të demonstronte se kishte karakter antifashist, se kishte vendosur autoritetin e saj në të gjithë vendin, se përfaqësonte vullnetin e popullit shqiptar dhe se do të plotësonte detyrimet ndërkombëtare.<sup>51</sup>

Kërkesa me shkrim e Enver Hoxhës për njohjen e qeverisë së tij nga tre Aleatët e Mëdhenj mbeti përkohësisht pa përgjigje. Asnjëri nuk pranoi të komunikonte direkt me Qeverinë Demokratike të Shqipërisë. Përgjigjet do të vinin gradualisht, jo nga diplomatët, por nga ushtarakët. Asnjëra nga tre qeveritë e Aleatëve të Mëdhenj nuk e njohu qeverinë e dalë nga Mbledhja e Beratit. Secila prej tyre po planifikonte të dërgonte në Shqipëri misione të veçanta, të cilat do të përgatisnin terrenin për njohjen e ardhshme të qeverisë shqiptare.

Mungesa e partive politike, eliminimi dhe largimi i detyruar nga Shqipëria në mbarim të luftës i kërre të Ballit Kombëtar dhe të Legalitetit, bëri që pushteti politik të binte plotësisht në dorën e PKSH. Ndryshe nga shumica e vendeve të tjera të Evropës Lindore e Qendrore e deri diku edhe nga Jugosllavia, në Shqipëri problemi i pushtetit politik u zgjidh që gjatë luftës. Enver Hoxha u tregua më konsekuent, madje edhe se vetë Tito në Jugosllavi, pavarësisht se ndoqi shembullin e tij për marrjen e pushtetit. Ai

<sup>49</sup> *Po aty.*

<sup>50</sup> *FRUS*, 1944, Diplomatic Papers, vol. III, p. 288.

<sup>51</sup> *Po aty.*

nuk i pranoi këshillat e Aleatëve Perëndimorë për të zgjeruar bazën qeverisëse të FNÇ, përmes përfshirjes në qeveri të elementëve nacionalistë të papërllyer me pushtuesit.

Me gjithë tonet e ashpra kundër qeverisë jugosllave në mërgim, të përdorura në Kuvendin e Dytë të Jajces, në nëntorin e vitit 1943 nga PKJ dhe Tito, asaj nuk iu mbyll dera përfundimisht. Pas sugjerimeve dhe këshillave të aleatëve britanikë dhe amerikanë, ata do ta modifikonin sjelljen e tyre, madje duke anashkuar edhe disa nga vendimet e marra në Jajce. Shenjën e parë e dhanë delegatët e Komandës Supreme të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë në takimin e tyre me përfaqësuesit e OSS në Kajro të Egjiptit në dhjetor 1943.<sup>52</sup> Në Jajce ishte marrë vendim që të mos njihej dhe të mos lejohej rikthimi i qeverisë jugosllave të Mbretit Peter II, ndërsa populli do të vendoste me vullnetin e tij të lirë për formën e qeverisjes dhe qeverinë që ata dëshironin. Por, pas takimeve dhe këshillave të Aleatëve anglo-amerikanë, ata e lanë të hapur derën për ndryshime dhe bashkëpunim me qeverinë mbretërore në emigracion. Kolonel Velebit-i që kryesonte delegacionin e mirëpriti bashkëpunimin me disa elementë të qeverisë në emigracion, të tillë si Ivan Suvashiç, Sava Kosanoviç, Milan Konstandinoviç dhe Rudolf Biçançiç.<sup>53</sup>

Hapi i dytë dhe më i rëndësishmi u bë më 14-17 qershor 1944, kur Tito me cilësinë e kryetarit të Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar u takua me Dr. Subashiç, kryeministër i qeverisë mbretërore jugosllave në emigracion. Bisedimet u mundësuan pas mbështetjes direkte të Winston Churchill. Të dy palët njohën njëri - tjetrin.<sup>54</sup> Prirja e bashkëpunimit do të vazhdonte e do të konkretizohej më tej në vitin 1945, pas vendimeve të marra në Konferencën e Jaltës për të përfshirë në qeverinë e Titos edhe disa ministra të qeverisë mbretërore jugosllave. Por në prag të zgjedhjeve të përgjithshme këtë të fundit u flakën nga qeveria.

### **“Vatra” dhe “Shqipëria e Lirë”: të njihen qeveritë e Frontit Nacionalçlirimtar**

Vendimet e Kongresit të Përmetit dhe veçanërisht krijimi i Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar me atributet e një qeverie provizore, zgjuan

<sup>52</sup> NARA, RG 226, Entry 5416, Contaniner 630, File 52905, OSS, US Army Forces in the Middle East. “Diskutime politike me Këshillin Antifashist Nacionalçlirimtar”, 13 dhjetor 1944.

<sup>53</sup> *Po aty*.

<sup>54</sup> *Po aty*, RG 226. Bisedimet Tito-Subashiç, 13-14 gusht 1944, f. 1-2.

interesin e emigracionit shqiptar në SHBA. Njoftimet për Kongresin e Përmetit, ndonëse jo të plota e kishin burimin nga thirrja që iu drejtua shqiptarëve të Amerikës gjatë kohës së mbajtjes së tij, nga një shkrim i Lame Kodrës [Sejfulla Malëshovës] i botuar në gazetën ‘Bashkimi’, nga thirrja e delegacioni ushtarak shqiptar që asistoi në takimin e Barit me aleatët anglo-amerikanë dhe nga informacionet jo zyrtare e zyrtare të përfituara nga OSS dhe Departamenti i Shtetit.

Në një artikull të Lame Kodrës të botuar në muajin korrik 1944 në gazetën “Bashkimi” me titull “dy fjalë për Shqiptarët e Amerikës”, i bëhej thirrje komunitetit shqiptar, që të bashkohej e solidarizohej me LNÇ dhe të jepnin ndihmën e tyre për çlirimin e vendit.<sup>55</sup> Artikulli e vinte theksin tek dy vendimet kryesore të Kongresit të Përmetit, siç ishin krijimi i Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar dhe i Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar. Thirrja i drejtohej vetëm ‘Vatrës’, të cilën e quante ‘kampionet e parimeve të demokracisë dhe lirisë kombëtare’, ndërsa organizatën “Shqipëria e Lirë” nuk e përmendte fare. Ndërmjet të tjerave vihej në dukje se nesër do të ndërtohej një Shqipëri e re, e lirë, demokratike dhe popullore.<sup>56</sup>

Delegacioni i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare në Bari, i përbërë nga kolonel Bedri Spahiu, nënkolonel Ramadan Çitaku dhe major Frederik Nosi, më 10 gusht u bëri thirrje nga Italia shqiptarëve të Amerikës, gazetës ‘Dielli’ e ‘Liria’ që të solidarizoheshin me vendimet e marra në Kongresin e Përmetit dhe të mbështesnin organet legjislative e ekzekutive të krijuara prej tij.<sup>57</sup> Ajo u kërkonte shqiptarëve të Amerikës të solidarizoheshin me LNÇ dhe ta ndihmonin atë sa të mundnin, pa dallim feje, krahine apo ideje. Promemoria nuk linte pa përmendur as mbështetësit e Mbretit Zog. “Gjithë simpatizantët e Zogut, që dëshirojnë të luftojnë ose të ndihmojnë sinqerisht në çlirimin e popullit t’onë dhe që pranojnë të mos shtrojnë në tryezën e bisedimit çështjen e regjimit të nesërm të popullit shqiptar mund dhe duhet të marrin pjesë në Front”.<sup>58</sup> Thirrja në përgjithësi nuk merrej me përmbajtjen e vendimeve të Kongresit të Përmetit, por u kërkonte shqiptarëve të Amerikës të solidarizoheshin me LNÇ dhe ta ndihmonin atë sa të mundnin, pa dallim feje, krahine apo ideje. Por, ajo

<sup>55</sup> *Po aty*, RG 226, Entry 16, Box 1098, File 95549. Lame Kodra, “Two words to the Albanians of America-Dy fjalë për shqiptarët e Amerikës”, f. 1-3.

<sup>56</sup> *Po aty*, f. 3.

<sup>57</sup> *AQSH*, F. 41/APL, V. 1944, D. 154, fl. 3-4. Thirrje drejtuar Drejtorisë së gazetave ‘Liria’ dhe ‘Dielli’, 10 gusht 1944.

<sup>58</sup> *Po aty*.

kishte edhe nota kritike. Ndhima e dhënë konsiderohej jo e plotë dhe jo rrallë edhe pa efekte konkrete. Shkaqet gjendeshin tek mungesa e lidhjeve direkte të këtyre dy organizatave me FNÇ.

Shqiptarët e Amerikës u informuan nga autoritetet zyrtare amerikane gati 3 muaj pas mbajtjes së Kongresit të Përmetit. Mosnjoftimi në kohë për këtë ngjarje të rëndësishme mbi të ardhmen e Shqipërisë dhe shqiptarëve u shoqërua me kritika e reagime të tyre. Ata fajësuan Zyrën e Informacioni të Luftës [ZIL] për transmetimin e vonuar të lajmit të mbajtjes së Kongresit të Përmetit, dhe për paraqitjen e pjesshme të vendimeve të tij. Gazeta “Dielli”, më 16 shtator 1944, botoi një artikull të posaçëm për këtë ngjarje. Editori bënte me faj ZIL, e cila, sipas tij, e kishte për detyrë të shpërndante shpejt dhe me korrektesë publikime të kësaj natyre. Por, njoftimi për Kongresin ishte i vonuar në kohë dhe i paplotë në përmbajtje, ndërkohë që kjo zyrë, zotëronte informacion të plotë për atë ngjarje. Shqiptarët e Amerikës sipas një dokumenti të OSS, u njohën me vendimet e Kongresit të Përmetit, në mesin e shtatorit të vitit 1944, jo nga ZIL, por nga një intervistë që Bedri Spahiu i kishte dhënë gazetës italiane ‘Il Voce di Napoli’ [Zëri i Napolit].<sup>59</sup>

Kritikat e gazetës ‘Dielli’ në adresë të Zyrës së Informacionit të Luftës u mbështetën nga Harry Fultz. Në një letër që ai i dërgoi Washingtonit [nga Italia] më 11 tetor 1944, Fultz i quante të justifikuar e të faktuar dyshimet e shfaqura nga autori i artikullit, si për publikimin e vonuar të Kongresit të Përmetit, ashtu edhe të përmbajtjes së tij.<sup>60</sup> Fultz hidhte poshtë propagandën e gjermanëve dhe të qeverisë kuislinge shqiptare, të cilët kishin përhapur lajmin e rremë, se gjoja flamuri shqiptar i afishuar në Kongresin e Përmetit ishte modifikuar nga organizatorët e Kongresit, duke i shtuar atij simbole komuniste. Fultz sqaronte, se flamuri shqiptar nuk ishte i falsifikuar. Fotot e bëra nga kapiten Stefani në Kongresin e Përmetit, të cilat Fultz ia përcolli Washingtonit, nuk e vërtetonin pretendimin e lartpërmendur. Shefi i SI [Intelligence Service] për Shqipërinë ndërmjet të tjerave, përcolli në Washington për Philip Adams dhe Departamentin e Shtetit fotot e bëra nga kapiten Stefan-i në Kongresin e Përmetit, së bashku me indikacionet e personave të fotografuar.

Më 6 qershor 1944, një grup shqiptarësh të Amerikës u mblodhën në Çikago, në një takim të gjerë, me iniciativën e Charles Calmer Hart [Çarls Kalmer Hart-ish ministër i SHBA në Shqipëri në vitet 1925-1928], në këtë

<sup>59</sup> NARA, RG 226, Entry 108, 16 shtator 1944.

<sup>60</sup> *Po aty*, RG 226, Entry 108. H. T. Fultz për Philip Adams, 11 tetor 1944.

kohë president i shoqatës ‘Miqtë Amerikanë të Shqipërisë’, dhe të Christ A. Lepon, si drejtues i Komitetit Shqiptar. Në takim u miratua një rezolutë e cila iu dërgua drejtuesve të Fuqive të Mëdha, ndërmjet të cilëve edhe SHBA.<sup>61</sup> Rezoluta përmbante dy kërkesa: *së pari*, që të njihej një qeveri shqiptare në mërgim, sikurse kishte qenë para datës 7 prill 1939, duke nënkuptuar Zogun dhe *së dyti*, që Shqipëria të pranohej si anëtare me të drejta të plota në Kombet e Bashkuara.

Konstandin Çekrezi ka shkruar se Fan Noli e braktisi idenë gati 3-4 vjeçare të mbështetjes së Zogut më 23 qershor 1944, sapo u informua nga zyrtarët amerikanë, se “çdo bisedim për të njohur Zogun si mbret duhej lënë mënjanë”. Fan Noli u shpreh në favor të qeverisë së dalë nga Kongresi i Përmetit.<sup>62</sup> Sidoqoftë, prononcimin zyrtar të Nolit si kreu i Kishës Ortodokse të Pavarur të shqiptarëve të Amerikës në favor të njohjes së qeverisë të dalë nga Kongresi i Përmetit do ta ndeshim në vjeshtën e vitit 1944, së bashku me prononcimet e ‘Vatrës’ e të ‘Shqipërisë së Lirë’. Krerët e këtyre dy organizatave kishin dijeni për krijimin e Komitetit Antifashist Nacional-çlirimtar në Kongresin e Përmetit. Qerim Panariti, Konstandin Çekrezi u takuan në Boston më 3 korrik 1944 dhe morën disa vendime, të cilat dëshmojnë se ishin ende në udhëkryq nëse do të njihnin Komitetin Antifashist Nacionalçlirimtar, një Komitet të kryesuar nga Zogu, apo një Front të Bashkuar me apo pa praninë e tij. Zogu kishte këmbëngulur dhe vazhdonte t’i refuzonte zgjidhjet e ofruara, duke pranuar se e vetmja alternativë e pranuar prej tij ishte njohja e një qeverie që do të kryesohej prej tij si sovranitet juridik.<sup>63</sup> Vendimet e marra më 3 korrik përfaqësuesit e “Vatrës” dhe “Shqipërisë së Lirë” ia paraqitën DSH më 11 gusht 1944, por nuk morën asnjë përgjigje pozitive ndaj alternativave që parashtruan.<sup>64</sup> Departamenti i Shtetit u tregua mjaft skeptik ndaj marrëveshjes së arritur nga “Vatra” dhe “Shqipëria e Lirë”. Komiteti Shqiptaro-Amerikan dhe apelet e Çekrezit u konsideruan si ‘budallallëqe të tij për qëllime propagandistike’.

<sup>61</sup> *Po aty*, Roll 16, 875.01/6-I 644. Christ A Lepon, James Koburi, Ismail Emin për Presidentin e Shtëpisë së Bardhë, 6 qershor 1944.

<sup>62</sup> Kostë Çekrezi, *Plani i Tretë për Copëtimin e Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2013, f. 71.

<sup>63</sup> NARA, Roll 15, Secret, 504, “Albania Basic Handbook”, gusht 1943.

<sup>64</sup> Beqir Meta, *Tensioni Greko-Shqiptar (1939-1949)*, Tiranë: GEER, 2002, f. 375; NARA, Roll 15, 875.00/8-1144. Memorandum bisede i takimit të Qerim Panaritit, Konstandin Çekrezit dhe Thoma Kotellit me Cavendish Cannon, Hohenthal e Huston në Departamentin e Shtetit, 11 gusht 1944.

Departamenti i Shtetit nuk e inkurajoi as krijimin e një qeverie të shqiptarëve në mërgim dhe as njohjen e qeverisë së dalë nga Kongresi i Përmetit.<sup>65</sup>

Opinioni i DSH apo i FO kishin mjaft peshë në gjykimet dhe vendimet e përfaqësuesve të emigracionit shqiptar. Sidoqoftë, në rrethanat kur Shqipëria nuk kishte asnjë qeveri të njohur si jashtë ashtu edhe brenda vendit, ndërkohë që Konferenca e ardhshme e Paqes ishte shfaqur në horizont, ata vendosën që t'i njihnin qeveritë e FNÇ, dhe këtë gjë e kërkuan edhe nga DSH dhe FO. Kërkesat e 'Vatrës', 'Shqipërisë së Lirë', Kishës Ortodokse Autoqefalë të shqiptarëve të Amerikës, degëve të tyre etj., për njohjen e Komitetit apo Qeverisë Provizore të dalë nga Kongresi i Përmetit fillojnë në vjeshtën e vitit 1944.

Më 6 tetor 1944, Qerim Panariti në emër të 'Vatrës' dhe Konstandin Çekrezi si kryetar i 'Shqipërinë së Lirë' u paraqitën në DSH dhe kërkuan që të njihet qeveria e Përmetit.<sup>66</sup> Panariti i dorëzoi përfaqësuesit të DSH një dokument, që provonte se kërkesa mbështetej nga rezoluta që kishte miratuar Komiteti i 'Vatrës'. Edhe Komiteti i organizatës 'Shqipëria e Lirë' më 17 shtator 1944 kishte vendosur që të njihet Qeveria Provizore e formuar në Përmet.<sup>67</sup> Përveçse mandatimit të marrë nga kuvendet e dy organizatave të lartpërmendura, Qerim Panariti dhe Kostë Çekrezi u paraqitën edhe në emër të Komitetit Shqiptaro-Amerikan.

Por diplomati amerikan, Huston, në DSH e refuzoi kërkesën e tyre. Ai u bëri të qartë bashkëbiseduesve, se njohja e saj do të thoshte ndërhyrje në punët e brendshme të Shqipërisë dhe njëkohësisht dhunim i parimeve të vetë kësaj qeverie, si zgjedhje e vetë popullit shqiptar. Nga nënteksti vihej re se qeveria e dalë nga Kongresi i Përmetit konsiderohej si një krijesë që nuk përfaqësonte të gjithë shqiptarët. Megjithëkëtë, Huston nuk ua mbylli derën përfundimisht përfaqësuesve të komunitetit shqiptaro-amerikan. Pasi i falënderoi për interesin që ata shfaqnin për vendin e tyre, jo pa ironi u

<sup>65</sup> NARA, Roll 15, 875.00/9-544. Koment i Divizionit të Çështjeve të Evropës Jugore në DSH në lidhje me memorandumun e zotit Adams për Shqipërinë, 5 shtator 1944.

<sup>66</sup> *Po aty*, Roll 16, 875.01/10-744. Department of State, Southern European Division (Divizioni i Evropës Jugore në Departamentin e Shtetit) Memorandum "Shqipëria", 7 tetor 1944.

<sup>67</sup> *Arkivi i Institutit të Historisë*, Tiranë (më tej: *AIH*), A.V.152, fl. 12. Nga letra e Tajar Zavalanit drejtuar Sekretarit Britanik për Punët e Jashtme, 30 tetor 1944.

sugjeroi që nëse do të kishin argumente të tjera për njohje, të mos hezitnin që t'i paraqitnin.<sup>68</sup>

Tajar Zavalani, si zëvendëskryetar i Komitetit të organizatës 'Shqipëria e Lirë' dhe i degës së saj në Londër, më 30 tetor 1944 i paraqiti sekretarit britanik të Punëve të Jashtme, Anthony Eden, një kërkesë për njohjen e qeverisë së Përmetit. Ndër të tjera, ai i bënte të ditur diplomatit më të lartë britanik, se për njohjen e saj ishte shprehur edhe imzot Fan Noli - kryetar nderi i 'Vatrës'. Më 2 nëntor 1944, Konstandin Çekrezi i drejtoi Presidentit Roosevelt një telegram me shumë ankesa e fajësime për qëndrimin e mbajtur nga Aleatët e Mëdhenj në përgjithësi dhe në veçanti nga qeveria amerikane ndaj çështjes shqiptare.<sup>69</sup> Ai ankohej për trajtimin e diferencuar që i ishte bërë Shqipërisë nga Presidenti, i cili nuk e kishte përmendur së fundmi emrin e saj në listën e gjatë të viktimave të agresionit fashist. Lista e kritikave ishte e gjatë. Ai i bënte të ditur Roosevelt-it se Shqipëria nuk ishte thirrur në Konferencën e Breton Woods-it, se Departamenti i Shtetit nuk e kishte njohur Komitetin Amerikano-Shqiptar të prezantuar prej tij më 11 korrik dhe më 17 gusht 1944, se nuk e kishin njohur qeverinë e dalë nga Kongresi i Përmetit, për shkak se ajo dominohej nga një bërthamë komuniste, se nuk kishin pranuar të njihnin asnjë qeveri të krijuar në mërgim, duke përfshirë edhe propozimet e ardhura nga 'Shqipëria e Lirë', madje nga Mbreti Zog, përmendte Çekrezi. Por, një ditë më pas Çekrezit i erdhi përgjigjja nga DSH. Cavendish Cannon, shef i Divizionit të Çështjeve të Evropës Jugore, e njoftoi se ishin njohur me përmbajtjen e telegramit dhe se shqetësimet e Çekrezit për çështjen shqiptare ishin edhe shqetësime të disa oficerëve të këtij Departamenti.<sup>70</sup>

'Vatra', 'Shqipëria e Lirë', Kisha Ortodokse dhe mjaft degë të tyre vazhduan të kërkonin nga qeveria amerikane që ajo të njihnte Qeverinë Demokratike, të dalë nga Mbledhja e Beratit. Konstandin Çekrezi më 14 dhjetor 1944, iu drejtua Sekretarit të ri sapoemëruar të Departamentit të Shtetit, Edward R. Stettinius, me kërkesën për njohje të qeverisë së Beratit. Ai iu lut gjithashtu Stettinius-it, që të ndërhynte edhe tek qeveritë e Britanisë së Madhe dhe të Rusisë, që edhe këto të bënin të njëjtën gjë. Njohja e shpejtë,

<sup>68</sup> NARA, Roll 16, 875.0I/10-744, Department of State, Southern European Division (Divizioni i Evropës Jugore në Departamentin e Shtetit), Memorandum: "Shqipëria", 7 tetor 1944.

<sup>69</sup> *Po aty*, Roll 16, 875.0I/11-344. Telegram i Konstandin Çekrezit për Franklin D. Roosevelt, Shtëpia e Bardhë, 2 nëntor 1944.

<sup>70</sup> *Po aty*.

sipas Çekrezit, do ta shpejtonte zbatimin e programit të UNRRA-s për Shqipërinë. Ai kërkoi gjithashtu që ndërmjet Amerikës dhe Shqipërisë të rivendosej komunikimi postal.<sup>71</sup>

Më 26 nëntor 1944 Noli, në emër të Kishës Ortodokse Shqiptare, i dërgoi Presidentit Roosevelt një telegram me disa kërkesa. Ai i kërkonte të njihej zyrtarisht qeveria e Beratit, që kjo e fundit të kishte të drejtë që të dërgonte delegacionin e saj në konferencën e Kombeve të Bashkuara, që Shqipëria të kishte të drejtë të përfaqësohej në Konferencën e Paqes dhe në çdo konferencë tjetër të Kombeve të Bashkuara, që të ndalohej ndarja e Shqipërisë nga fqinjët e saj më të fuqishëm, dhe së fundi, të lejohej dërgimi i ndihmave për popullin shqiptar.<sup>72</sup>

### *S u m m a r y*

#### THE USA'S REFUSAL TO RECOGNIZE THE GOVERNMENTS ESTABLISHED IN THE CONGRESS OF PERMET AND THE CONVENTION OF BERAT, MAY-NOVEMBER 1944

This article deals with an important and controversial question of the WWII, namely the Antifascist National Liberation Committee [functioning as a Provisory Government] and the Provisory Democratic Government, established respectively in the Congress of Permet and the Convention of Berat, and the American government's attitude towards them.

The period from May to November 1944 marks a peculiar stage in the relations of the Antifascist National Liberation Front (ANLF) with the Allies. During this period the military assignments for the liberation of the country mingle with political aims. *Firstly*, the establishment of the Antifascist National Liberation Committee in the Congress of Permet, which functioned as a Provisory Government and the Provisory Democratic Government set up in the Convention of Berat were not recognized by the Allies; *secondly*, the two western Allies in the meeting of Bari [July-August 1944] recognized the Antifascist Liberation Movement (ALM) as the only resistance movement in Albania. After this decision, with the initiative of the British Foreign Secretary, Anthony Eden, on 5 October 1944 the Allies withdrew

---

<sup>71</sup> *Po aty*, Roll 16, 875.0I/12-1444. Konstandin Çekrezi për Edward Stettinius, 14 dhjetor 1944.

<sup>72</sup> *Po aty*, Roll 16, 875.0I/11- 2644. Fan Noli për Sekretarin e Shtetit Cordell Hull, 26 nëntor 1944.

their support for *Balli Kombetar* and *Legaliteti*; lastly, the three Allies took respective decisions to send to Albania their missions which would collect information on the situation in the country and later proceed with the formal recognition of the new regime. The American government sent to Albania a non-official civil mission, headed by the experienced diplomat Joseph E. Jacobs, while the British and Soviet governments assigned military missions.

In preparing this article I have made extensive use of various sources, most notably American and Albanian archival documents and several published books and articles.